

1. PAMJE E PËRGJITHËSHME

Viti 2001 ka filluar me një aktivitet mjaft intensiv në sektorin e jashtëm të shprehur në rritjen e konsiderueshme të të ardhurave e shpenzimeve korente dhe flukseve të kapitalit.

Keshtu llogaria korente në fund të tremujorit u mbyll me një deficit prej 47.1 milionë dollarësh, i cili është shkaktuar kryesisht nga rritja e deficitit tregtar të mallrave.

Deficiti i transaksioneve korente është financuar prej flukseve hyrëse të kapitaleve, bilanci pozitiv i të cilave, në fund të periudhës, vlerësohet me rreth 56 milionë dollarë dhe përfaqëson 80 për qind të tremujorit të parë të vitit të kaluar.

Pas kësaj shifre pozitive, qëndrojnë transfertat kapitale prej rreth 28 milionë dollarësh dhe bilanci pozitiv i llogarisë financiare prej rreth 48 milionë dollarësh.

Rezervat e autoritetit monetar, në tremujorin e parë të këtij viti, u rritën me 56 milionë dollarë. Faktori kryesor që ka çuar në rritjen e rezervave valutore kanë qenë investimet e huaja direkte nga privatizimi.

TABELA 1. BILANCI I PAGESAVE GJATË VITEVE (në mln USD)

	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	3M-I '00	3M-I '01
LLogaria Korrente	14.7	31.2	36.6	-62.4	-253.7	-45.2	-132.9	-155.6	-16.1	-47.1
Eksporti i mallrave fob	111.7	141.3	204.8	243.7	158.6	208.0	275.1	255.9	61.6	78.5
Importi i mallrave fob	-601.6	-601.0	-679.8	-922.0	-693.5	-811.7	-937.9	-1,070.1	-227.3	-285.4
Bilanci tregtar	-489.9	-459.7	-475.0	-678.3	-534.9	-603.6	-662.8	-814.1	-165.7	-206.9
Shërbimet: Kredi	77.5	83.1	98.2	127.3	67.9	94.6	266.7	448.1	153.3	122.7
Shërbimet: Debi	-162.0	-97.5	-106.3	-142.3	-101.1	-133.7	-165.4	-429.3	-80.0	-106.7
Të ardhurat: Kredi	64.9	55.6	70.8	83.5	61.6	86.1	85.6	115.9	19.0	28.6
Të ardhurat: Debi	-31.0	-41.5	-28.5	-12.0	-11.9	-8.7	-10.3	-9.1	-2.0	-2.4
Transfertat private	274.8	374.1	348.9	476.0	235.7	437.7	188.4	438.6	52.3	110.6
Transfertat shtetërore	280.4	117.2	128.5	83.4	29.0	82.5	165.0	94.4	7.0	7.1
Llogaria kapitale	0.0	21.6	389.5	4.9	2.1	31.1	67.5	78.2	19.5	29.1
Llogaria financiare	104.2	24.2	392.2	49.6	140.7	14.1	36.8	180.6	34.4	28.6
Investime direkte	58.0	52.9	70.0	90.1	47.5	45.0	41.2	143.0	20.0	58.2
Investime portofoli	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	-25.0	0.0	-1.8
Kapitale të tjera	35.5	-6.9	-95.0	-35.6	95.3	0.6	-11.2	62.6	14.4	-34.8
Gabime dhe harresa	-9.9	-44.6	7.9	54.9	142.5	55.0	131.2	9.4	-44.7	47.9
Bilanci i përgjithshëm	114.9	54.8	30.6	47.0	43.8	63.3	116.7	131.9	6.2	56.3
Rezerva & zëra të lidhur me të										
Mjetet e rezervës	-114.9	-54.8	-30.6	-47.0	-43.8	-63.3	-116.7	-131.9	-6.2	-56.3
Përdor. kred. & huash nga fondi	16.6	22.2	11.1	0.0	12.2	7.9	20.9	19.3	13.1	6.1
Det. ndaj Auto. Monet. të Huaja
Financime të jashtëzakonshme
Për t'u përmendur										
Ndryshim i Rezervave	118.7	-54.8	-30.6	-39.5	-28.3	-75.9	-97.4	-130.5	5.4	-34.5
Efekte nga Kursi i Këmbimit	-3.8	7.3	5.1	-7.3	-15.5	12.6	-26.2	-3.5	-11.5	-13.7

Aktiviteti i *tregtisë së jashme* në mallra gjatë tremujorit të parë është rritur ndjeshëm dhe vlerësohet rreth 27 për qind më i lartë se ai i tremujorit të parë të vitit 2000. Rritja i dedikohet si eksporteve ashtu edhe importeve. Importet vlerësohen 285 milionë dollarë dhe janë rreth 26 për qind më të larta se në tremujorin e parë të vitit 2000, ndërkohë që eksportet regjistruan shifrën 79 milionë dollarë me të njëjtën rritje kundrejt të njëjtës periudhë. Për rrjedhim, deficitin tregtar në fund të tremujorit është rritur 25 për qind kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë.

Bilanci i shërbimeve këtë tremujor u kthye përsëri në shifra pozitive pas deficiteve të tre tremujorëve të fundit të vitit 2000. Suficiti i tregtisë së shërbimeve për tremujorin e parë vlerësohet rreth 16 milionë dollarë dhe zë vetëm 22 për qind të suficitit të tremujorit të parë të vitit të kaluar. Eksporti i shërbimeve vlerësohet në rreth 123 milionë dollarë dhe kjo është mundësuar kryesisht prej shërbimeve të turizmit, të cilat zënë rreth 80 për qind të kësaj shume, pjesën tjetër e përfaqësojnë shërbimet e telekomunikacionit dhe ato qeveritare. Importi i shërbimeve vlerësohet rreth 107 milionë dollarë. Në shpenzimet për importin e shërbimeve peshën kryesore e zënë shërbimet e turizmit dhe ato të transportit, respektivisht me 60 dhe 22.4 për qind. Këto të fundit janë rritur rreth 18 për qind kryesisht si pasojë e rritjes së importit.


Bilanci i të ardhurave vlerësohet me rreth 26 milionë dollarë ose 54 për qind më i lartë se tremujori i parë i një viti më parë. Kjo rritje është mundësuar kryesisht prej të ardhurave më të larta nga investimet dhe të ardhurave nga puna e punonjësve sezonalë.

Transferrat korente vlerësohen me një bilanc pozitiv prej 118 milionë dollarësh. Rolin kryesor në këtë suficit e luajnë dërgesat nga emigrantët, që për këtë tremujor, vlerësohen rreth 124 milionë dollarë amerikanë ose rreth 2 herë më të larta se në tremujorin e parë të vitit të kaluar.

Flukset neto të kapitaleve në fund të periudhës, vlerësohen me rreth 56 milionë dollarë dhe përfaqëson 80 për qind të tremujorit të parë të vitit të kaluar. Pas kësaj shifre pozitive, qëndrojnë transfertat kapitale prej rreth 28 milionë dollarësh dhe bilanci pozitiv i llogarisë financiare prej rreth 48 milionë dollarësh. Vihet re

rritja e detyrimeve financiare kundrejt jorezidentëve prej 84 milionë dollarësh, ku rolin kryesor e kanë luajtur investimet e huaja direkte dhe disbursimet e kredive të huaja. Kështu investimet e huaja regjistruan shifrën 58 milionë dollarë, shifër kjo që vjen kryesisht nga privatizimi.

Vlen të përmendet që këtë fillim viti, në dallim nga tremujori i parë i vitit të kaluar,




shfaqen investimet e portofolit.

Grafik 1. LLOGARITË E BILANCIT TË PAGESAVE – BALANCE OF PAYMENTS ACCOUNTS

2. LLOGARIA KORENTE

Deficiti i llogarisë korente në fund të tremujorit të parë të vitit 2001 vlerësohet rreth 47 milionë dollarë, shifër kjo rreth 3 herë më e lartë se tremujori i parë i vitit të kaluar ndërkohë që zë vetëm 46 për qind të tremujorit paraardhës. Ky deficit është rrjedhojë kryesisht e deficitit tregtar të mallrave.

Deficiti i llogarisë korente, përjashtuar transfertat shtetërore, këtë tremujor vlerësohet 2.2 herë më i lartë se e njëjta periudhë një vit më parë, por përfaqëson rreth 22 për qind të atij të tremujorit paraardhës duke regjistruar shifrën 54.2 milionë dollarë.



Grafik 2. LLOGARIA KORENTE DHE BILANCI FISKAL– CURRENT ACCOUNT AND FISCAL BALANCE

2.1 TREGTIA E JASHTME


Tremujori i parë i vitit 2001 shënoi gjallërim në aktivitetin tregtar të Shqipërisë me botën. Volumi i përgjithshëm i tregtisë së jashtme, realizuar gjatë tremujorit të parë të vitit, u vlerësua në nivelin 364 milionë dollarë. Ky volum u vlerësua rreth 6 për qind më i ulët se ai i tremujorit paraardhës. Megjithatë, volumi tregtar vlerësohet rreth 26 për qind më i lartë kundrejt tremujorit të parë të vitit të kaluar. E gjithë kjo rritje i dedikohet si importeve ashtu edhe eksporteve.

I vlerësuar në rreth 285 milionë dollarë, importi tregtar përfaqëson volumin më të lartë të realizuar në periudha fillimvitesh. Megjithëse 11 per qind më i ulët krahasuar me tremujorin e katërt të vitit të kaluar, importi u vlerësua në një nivel 25 për qind më të lartë kundrejt periudhës korresponduese. Kanë ndikuar në këtë rritje importet e larta në produkte minerale dhe zhvillimet pozitive në fushën e investimeve duke rritur importin e makinerive dhe të pajisjeve. Krahasuar me tremujorin paraardhës importi vlerësohet rreth 11 për qind më i ulët.

Muaji mars përfaqëson periudhën me volumin më të lartë të importit brenda tremujorit.

Eksporti i mallrave, i vlerësuar në rreth 79 milionë dollarë, regjistroi një rritje si kundrejt periudhës paraardhëse me rreth 26 për qind, ashtu edhe rreth 27 për qind, kundrejt të njëjtës periudhë një vit më parë. Rol kryesor në këtë rritje kanë

luajtur rritja në produktet minerale, në tekstile dhe artikuj tekstile si dhe rieksperti nga përpunimi aktiv rreth 30 për qind. Edhe në eksport muaji mars ka kapur



shifrën më të lartë në këtë tremujor.

Grafik 3. TENDENCA NE ECURINE E EKSPORTIT DHE TE IMPORTIT

Importet ndihma vlerësohen në rënie si ndaj tremujorit paraardhës rreth 2 herë ashtu edhe krahasuar me periudhën korresponduese një vit më parë rreth 1.5 herë. Ndihamat ishin kryesisht në produkte të industrisë tekstile dhe në makineri e pajisje.

Rritja e volumit të tregtisë në mallra u shoqërua me thellimin e deficitit tregtar. Kështu, në fund të tremujorit të parë të këtij viti ai regjistroi rreth 207 milionë dollarë. Ky deficit vlerësohet rreth 25 për qind më i lartë se periudha korresponduese një vit më parë. Ndaj kësaj periudhe deficitit ka qenë më i ndjeshëm në grupmallrat produkte minerale dhe makineri e pajisje. Ndërkohë që, krahasuar me tremujorin paraardhës ky deficit është 21 për qind më i ulët.

Rezerva valutore bruto, në tremujorin e parë të vitit 2001, vlerësohet e mjaftueshme për të përballuar 6.8 muaj importe.

**Tabela 2. TREGTIA E JASHTME SIPAS TREMUJOREVE PER PERIUDHEN '94-'01
(ne mln USD)**


Periudha	Eksporte	Ndryshimi në % ndaj periudhës paraardhëse	Importe	Ndryshimi në % ndaj periudhës paraardhëse
Q1 1994	27.9	-19.7	-122.1	-29.7
Q2 1994	30.7	10.0	-149.0	22.1
Q3 1994	30.9	0.6	-155.0	4.0
Q4 1994	51.8	67.5	-174.9	12.8
Q1 1995	42.0	-19.0	-163.5	-6.5
Q2 1995	51.1	21.8	-177.0	8.2
Q3 1995	57.3	12.0	-150.4	-15.0
Q4 1995	54.5	-4.8	-188.8	25.5
Q1 1996	68.0	24.8	-208.4	10.3
Q2 1996	57.1	-16.0	-209.6	0.6
Q3 1996	56.5	-1.1	-225.2	7.4
Q4 1996	62.1	9.9	-278.8	23.8
Q1 1997	34.2	-44.8	-143.9	-48.4
Q2 1997	42.2	23.2	-114.5	-20.4
Q3 1997	41.3	-2.1	-171.1	49.3
Q4 1997	40.9	-0.9	-264.0	54.3
Q1 1998	42.2	3.2	-176.8	-33.0
Q2 1998	49.3	16.8	-198.1	12.1
Q3 1998	53.0	7.5	-196.1	-1.0
Q4 1998	63.4	19.6	-240.6	22.7
Q1 1999	72.9	15.0	-185.6	-22.9
Q2 1999	78.4	7.5	-250.1	34.8
Q3 1999	58.6	-25.2	-252.1	0.8
Q4 1999	65.1	11.1	-250.1	-0.8
Q1 2000	61.6	-5.4	-227.3	-9.1
Q2 2000	68.5	11.2	-257.3	13.2
Q3 2000	63.5	-7.3	-261.1	1.5
Q4 2000	62.2	-2.1	-324.3	24.2
Q1 2001	78.5	26.2	-288.5	-11.0

Struktura në Eksporte dhe Importe sipas Përpunimit Aktiv

Aktiviteti tregtar në fushen e përpunimit aktiv zë një vend të rëndësishëm në tregtinë e vendit tonë, me 70 për qind në eksporte dhe 16 për qind në importe.

Eksporti këtë tremujor identifikohet në rritje, si në riekспорт nga fusha e përpunimit aktiv ashtu edhe në eksportin e brendshëm. Keshtu, rritja në eksportin e brendshëm dhe në rieksporte u vlerësua, përkatësisht në 35 dhe 25 për qind kundrejt tremujorit të parë të vitit 2000. Rieksporetet, të cilat përfaqësojnë përgjithësisht aktivitetin e subjekteve me kapital të huaj, kryesisht

në industrinë e veshjeve dhe përpunimin e lekureve, janë rritur me rreth 26 për qind. Eksportet në tekstile dhe kepuçë, me përkatësisht 46 dhe 39 për qind në totalin e rieksperteve nga përpunimi aktiv, mbeten grupmallrat kryesorë përpunuese në vend.



Grafik 4. BILANCI TREGTAR (ne mln USD)

Importi për përpunim aktiv regjistroi zhvillime pozitive këtë fillimviti. Realizimi i importeve të kësaj kategorie vlerësohet 3 herë më i lartë kundrejt tremujorit të parë të vitit të kaluar. Importi për përpunim aktiv hyn kryesisht si importe në tekstile, këpuçë dhe lëkurë, përkatësisht në masat 36, 17 dhe 10 për qind. Importet në tekstile dhe këpuçë regjistruan rritje prej 3.1 herë kundrejt tremujorit korrespondues të vitit 2000, po kështu importet në lëkurë kundrejt të njëjtës periudhë një vit më parë janë rritur 3.2 herë.

Importi dhe Eksporti sipas Grupmallrave

Importi tregtar regjistroi tendenca në rritje përgjatë tremujorit të parë 2001. Rritja e importeve u fokusua kryesisht në grupmallrat produkte minerale, tekstile, makineri e pajisje. Fillimviti shfaqti tendenca pozitive në fushën e investimeve. Kështu, volumi i importeve në makineri e pajisje u rrit 1.7 për qind ndaj tremujorit të parë të vitit 2000. Ky grupmall zë rreth 15 për qind të totalit të importit.

TABELA 3. IMPORTI SIPAS 21 GRUPMALLRAVE

	1996 1997 1998 1999 2000					prill maj qersh korrik gusht shtator tetor nëntor dhjetor janar shkurt mars											
Kafshët e gjalla; Produkte me origjine kafshore	47.1	27.4	42.4	41.4	30.3	3.6	2.5	2.1	2.7	1.5	2.1	2.7	2.5	3.0	1.7	1.8	2.5
Produkte vegjetale	163.0	85.3	83.0	85.9	90.7	6.4	10.1	6.1	5.8	7.7	6.3	6.0	6.4	11.4	7.8	9.0	9.1
Vajra dhe yndyra kafshore apo vegjetale	26.7	20.7	27.1	18.0	21.3	3.4	2.0	1.8	1.3	2.0	1.3	1.8	1.3	2.2	1.0	1.8	1.1
Ushqime të përgatitura, pije, duhan	88.5	47.0	73.0	108.8	97.6	8.1	7.5	9.6	8.8	8.5	9.2	8.4	8.3	8.4	7.6	6.9	8.8
Produkte minerale	48.6	49.2	70.0	81.3	141.7	8.7	9.1	10.3	11.6	12.5	12.7	11.8	22.4	16.7	15.9	13.8	17.9
Produkte të industrisë kimike apo ind. të lidhjeve	45.1	38.3	61.8	51.4	60.4	5.9	3.3	4.5	5.5	5.1	5.0	4.3	3.4	6.0	3.6	6.1	6.4
Plastika; goma dhe artikuj të tyre	21.5	19.9	25.0	26.6	31.9	2.3	2.8	3.2	2.9	3.0	3.1	2.9	2.8	2.7	2.4	2.3	3.3
Lëkura, artikuj të tyre	19.8	14.4	19.0	21.1	19.0	1.7	1.5	2.0	1.7	0.8	1.6	1.4	2.2	1.6	1.9	2.6	2.3
Druri, tapa art. e tyre; prodhime kashte, kallama	7.4	7.6	10.2	16.2	10.4	0.7	0.8	1.1	1.0	0.8	0.8	1.0	0.8	1.1	0.8	0.9	0.7
Brumi i drurit, letra, kartoni art. të tyre	13.4	8.5	12.8	14.3	17.0	1.1	1.5	1.2	1.8	1.4	1.8	1.5	1.2	1.6	1.2	1.2	1.5
Tekstile dhe artikuj tekstile	84.3	66.8	106.2	118.1	128.5	9.0	11.5	11.1	14.7	8.6	13.0	10.8	11.8	11.2	10.1	9.9	10.7
Veshjet e këmbëve, të kokës, cadrat	58.6	36.9	40.4	34.8	27.7	2.5	3.5	2.8	3.5	3.4	3.7	3.5	3.4	3.4	3.3	3.8	4.4
Art. prej guri, allcie, cimentoje; qeramike; qelq	22.3	22.3	28.7	30.1	41.9	3.1	4.1	3.5	3.8	3.1	4.7	3.9	4.0	4.1	2.6	3.3	2.8
Perla; bizhuteri; monedha	1.3	0.2	0.4	0.9	2.7	0.9	0.4	0.7	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.5	0.0	0.0	0.0
Metalet bazë dhe artikujt prej tyre	44.8	42.8	54.8	75.8	83.8	7.9	6.5	5.8	7.7	6.0	7.4	11.5	7.9	9.1	6.1	7.5	7.8
Makinieri e pajisje mekanike, elektrike	151.3	101.9	81.1	108.9	148.9	10.9	9.2	9.9	11.8	10.7	11.9	15.5	14.8	28.9	13.2	12.7	17.5
Mjete transporti	57.2	31.9	55.1	70.6	80.1	7.7	6.2	7.3	6.5	6.4	5.1	6.3	5.6	6.2	6.2	6.0	5.8
Instrumente e aparate optike; orë; instr. muzikore	12.4	8.1	8.7	13.1	18.6	1.2	1.0	2.1	1.9	1.8	1.8	1.7	0.6	4.1	2.1	0.7	2.1
Armë e municione; pjesët e plotësuesit e tyre	0.7	0.5	0.7	2.0	0.4	0.1	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.0	0.0	0.0	0.1	0.0	0.1
Artikuj të ndryshëm të prodhuar	19.1	14.6	21.4	23.6	26.0	1.9	3.0	2.1	2.5	1.8	2.0	2.5	2.6	2.5	1.5	1.9	2.0
Vepra arti, copa të mbledhura nga antikitet	0.1	0.0	1.7	0.0	0.3	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.2	0.0	0.0	0.0
TOTALI	933.1	644.4	823.5	943.0	1079	87.1	86.5	87.3	92.1	81.9	90.2	97.6	101.9	124.8	89.3	92.5	107

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Statistikat e publikuara u përshtaten kornizave metodologjike të BOP.

Importi në produktet minerale i cili këtë tremujor zë rreth 17 për qind të totalit të importeve, vlerësohet rreth 6 për qind më i ulët se tremujori paraardhës, por krahasuar me tremujorin e parë të vitit të kaluar importi në produkte minerale është rritur 1.8 herë.

Grupmali tekstile dhe artikuj të tyre, këtë tremujor, u vlerësua në rritje ndaj periudhës paraardhëse, rreth 14 për qind. Italia përfaqëson tregun kryesor në këto importe.

Importi në grupmallin ushqim, pije dhe duhan u karakterizua nga tendenca në rënie kundrejt tremujorit paraardhës me rreth 7 për qind, ndërkohë që krahasuar me fillimvitin e kaluar importi i këtij grupmali është rritur me 12 për qind.

Grupmali metalet bazë dhe artikujt prej tyre këtë tremujor regjistroi një shifër rreth 1.5 herë më të lartë se periudha korresponduese një vit më parë.

Importet në mjete transporti, kanë ruajtur të njëjtin nivel me tremujorin paraardhës, por paraqitet me rënie kundrejt një viti më parë, me rreth 21 për qind.

Vihet re një rritje e importeve në grupmallin produkte të industrisë kimike kundrejt tremujorit paraardhës prej rreth 18 për qind. Krahasuar me tremujorin e parë të vitit të kaluar importi në këtë grupmall vlerësohet 7 për qind më i ulët.

Ndërkohë që, ritme pozitive shfaqti importi në grupmallin veshjet e këmbëve, të

kokës. Kështu, këto vlerësohen 35 për qind më të larta ndaj periudhës korresponduese të një viti më pare dhe rreth 12 për qind kundrejt periudhës paraardhëse.

Eksporti tregtar paraqitet me rritje si kundrejt tremujorit paraardhës ashtu edhe ndaj periudhës korresponduese të vitit 2000. Rritja e eksporteve është rrjedhojë kryesisht e rritjes në grupmallrat kryesorë tekstile, makineri e pajisje dhe metale bazë.

Eksporti në grupmallin tekstile dhe këpucë, i ardhur kryesisht nga industria e përpunimit në vend, kryeson eksportet tona në një total prej 39.2 për qind të volumit. Këtë tremujor eksportet e këtij grupmali u rritën me 39 dhe 39.5 për qind respektivisht kundrejt periudhës korresponduese dhe periudhës paraardhëse të vitit të kaluar.

Tabela 4. EKSPORTI SIPAS 21 GRUPMALLRAVE

	1996	1997	1998	1999	2000	prill	maj	qersh	korrik	gusht	shtator	tetor	netor	dhjetor	janar	shkurt	mars
Kafshët e gjalla; Produkte me origjine kafshore	6.9	4.1	4.1	3.4	1.8	0.1	0.3	0.3	0.2	0.2	0.2	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
Produkte vegjetale	16.0	15.5	16.2	12.6	12.1	0.7	0.8	0.8	1.2	1.4	1.4	1.2	1.2	0.7	1.0	0.8	1.1
Vajra dhe yndyra kafshore apo vegjetale	4.8	0.0	0.5	0.4	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Ushqime të përgatitura, pije, duhan	9.2	9.0	12.6	12.7	13.7	0.3	0.8	1.7	1.6	1.3	1.6	2.1	0.9	0.5	0.7	0.8	1.0
Produkte minerale	23.1	8.4	23.7	17.5	7.4	0.3	1.3	3.7	0.6	0.5	0.3	0.2	0.1	0.2	0.1	2.3	0.5
Produkte të industrisë kimike apo ind. të lidhjeve	2.6	1.2	0.7	0.7	1.4	0.1	0.1	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.2	0.2	0.1	0.1	0.1
Plastika; goma dhe artikuj të tyre	1.2	0.5	1.1	1.3	0.9	0.0	0.2	0.1	0.2	0.0	0.1	0.0	0.0	0.1	0.0	0.2	0.0
Lëkura, artikuj të tyre	10.2	8.2	6.6	7.0	8.3	0.6	0.6	0.7	0.6	0.6	0.8	0.7	0.8	1.0	1.1	0.9	1.2
Druri, tapa art. e tyre; prodhime kashte, kallama	6.2	5.3	5.6	6.4	7.3	0.6	0.5	0.5	0.8	0.3	1.1	0.7	0.7	0.5	0.5	0.9	0.8
Brumi i drurit, letra, kartoni art. të tyre	3.1	3.7	2.9	4.6	2.6	0.2	0.3	0.2	0.1	0.1	0.3	0.2	0.2	0.3	0.2	0.1	0.1
Tekstile dhe artikuj tekstile	54.7	36.2	69.6	98.3	108.7	7.6	7.5	10.2	16.4	9.3	13.6	6.5	7.4	8.1	8.9	10.4	11.4
Veshjet e këmbëve, të kokës, cadrat	52.6	27.4	40.7	67.9	69.0	6.3	5.8	5.2	6.6	2.7	4.9	5.5	5.9	6.6	6.5	7.6	9.0
Art. prej guri, allacie, cimentoje; qeramike; qelq	0.4	0.4	1.7	0.6	0.7	0.1	0.0	0.1	0.1	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1
Perla; bizhuteri; monedha	0.1	0.1	0.2	0.8	0.5	0.0	0.0	0.0	0.2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Metalet bazë dhe artikuj prej tyre	25.4	14.3	9.4	14.6	21.5	1.7	2.3	2.2	1.9	1.8	1.8	2.2	1.7	1.4	2.4	2.3	2.3
Makineri e pajisje mekanike, elektrike	3.8	7.4	4.3	12.4	4.4	0.2	0.2	0.6	0.4	0.2	0.5	0.7	0.4	0.2	0.3	0.4	0.3
Mjete transporti	0.1	0.5	1.2	5.0	0.2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0	0.2
Instrumente e aparate optike; orë; instr. muzikore	0.2	0.1	0.8	0.4	0.5	0.0	0.3	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Armë e municione; pjesët e plotësuesit e tyre	0.7	0.0	0.0	0.0	1.7	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.5	0.5	0.5	0.0	0.0	0.0
Artikuj të ndryshëm të prodhuar	3.2	3.4	6.1	7.9	7.1	1.2	0.6	0.5	0.6	0.2	0.7	0.0	0.7	0.0	0.4	0.5	0.4
Vepra arti, copa të mbledhura nga antikrat	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
TOTALI	224.5	145.9	208.0	274.4	255.9	20.0	21.7	26.8	24.9	16.1	22.5	20.8	21.0	20.4	22.5	27.4	28.6

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Statistikat e publikuara u përshtaten korrigjime metodologjike të BOP.

Eksporti në grupmallin veshje koke që përfaqëson rreth 30 për qind të totalit të eksporteve është rritur me rreth 28 për qind nga tremujori paraardhës dhe njëkohësisht paraqitet me një rritje prej 20 për qind kundrejt tremujorit të parë të vitit 2000.

Eksporti në metale bazë shfaq tendencë pozitive zhvillimi përgjatë këtij fillimviti. Kështu tremujori i parë regjistroi një shifër 1.5 herë më të lartë se periudha

korresponduese e vitit paraardhës. Metalet përfaqësojnë grupmallin kryesor në eksportin e brendshëm.

Eksporti në produkte minerale pësoi një rritje si ndaj tremujorit paraardhës ashtu edhe krahasuar me periudhën korresponduese të një viti më parë, respektivisht 5.7 dhe 15 herë.

Partneret Tregtare

Aktiviteti tregtar i Shqipërisë me botën zhvillohet me orientimin kryesor vendet e Bashkimit Europian. Mëse 86 për qind e transaksioneve tregtare, përgjatë tremujorit, janë kryer me vendet e BE-se. Tregtia me këto vende vlerësohet në rritje kundrejt tremujorit korrespondues të një viti më parë (24 për qind). Kështu importi me këto vende përfaqëson 77 për qind, ndërsa eksporti 95 për qind. Krahasuar me tremujorin e parë të vitit paraardhës, si eksporti ashtu edhe importi vlerësohen respektivisht 29 dhe 23 për qind më të lartë. Edhe këtë tremujor Italia rezulton partneri më i madh i Shqipërisë në tregti me 42 për qind të volumit tregtar, pasuar nga Greqia me 24 për qind.

Krahasuar me fillimvitin e kaluar tregtia me vendet e Europës Lindore u rrit me rreth 18 për qind. Zgjerimi i aktivitetit tregtar me Rusinë dhe Slloveninë ndikoi në masën më të madhe në rritje të importeve me vendet e Europës Lindore. Eksportet me këto vende vlerësohen rreth 26 për qind më të ulta se tremujori i parë i vitit paraardhës. Me pjesën tjetër të botës, tregtia e zhvilluar kryesisht me Turqinë, Maqedoninë, SHBA, Kroacinë dhe Jugosllavinë, vlerësohet 41 për qind më e lartë ndaj tremujorit korrespondues një vit më parë.

Shkëmbimet tregtare me Italinë

Italia mbetet kryesuese në aktivitetin tregtar të Shqipërisë me botën. Kundrejt tremujorit paraardhës të vitit në vazhdim, tregtia me Italinë si volum paraqiti një rritje prej 1.7 për qind duke regjistruar rënie në import me 9.2 për qind dhe një rritje në eksport me 27 për qind. Ndërkohë, krahasuar me tremujorin e parë, volumi i tregtisë me Italinë është rritur 16.4 për qind. Kjo rritje pasqyrohet ëe të dy komponentet e saj si në eksport me 29 për qind ashtu edhe në import me

rreth 10 për qind. Ndikimin më të madh në këtë rritje, këtë tremujor, e dha rritja e volumit të tregtisë në grupmallrat tekstile dhe keçucë.

Shkembimet tregtare me Greqinë

Aktiviteti tregtar me Greqinë, gjatë këtij tremujori u vlerësua 4.5 për qind më i ulët, krahasuar me tremujorin paraardhës. Kjo rënie ka ardhur si pasojë e rënies së importit me 6.9 për qind, ndërkohë që eksporti u rrit me 25 për qind. Krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2000 tregtia me këtë shtet, gjatë këtij tremujori, ka shënuar ritme pozitive. Kështu, volumi tregtar është rritur rreth 25 për qind; importi me një rritje prej 24 për qind dhe eksporti rreth 36 për qind. Grupmali tekstile dhe artikujt e tyre, që zë edhe rreth 65 për qind të eksportit me Greqinë është rritur rreth 1.8 herë, ndërkohë grupmali makineri e pajisje i cili është rritur me rreth 5 herë ka ndikuar në rritjen e importit.

Shkëmbimet tregtare me Gjermaninë


Tremujori i parë i vitit 2001 e rriti në një nivel 12.7 për qind më të lartë aktivitetin tregtar me Gjermaninë, kundrejt tremujorit paraardhës dhe 23.8 për qind më të lartë kundrejt tremujorit korrespondues një vit më parë. Të dy komponentët tregtarë vlerësohen në rritje kundrejt një viti më parë. Importi dhe eksporti u rritën me përkatësisht 7 dhe 4 për qind. Importet e larta në mjete transporti, përbëjnë shkakun kryesor në rritje të volumit të importit. Gjermania ishte ndër furnizuesit kryesorë të kërkesës së lartë në mallra ushqimore.

2.2 SHERBIMET

Pas deficiteve të njëpasnjëshme të regjistruara në tre tremujorët e fundit të vitit 2000, bilanci i shërbimeve këtë tremujor iu kthye përsëri shifrave negative. Kështu suficiti i bilancit të shërbimeve për tremujorin e parë vlerësohet rreth 16 milionë dollarë dhe përfaqëson 22 për qind të tremujorit të parë të vitit të kaluar.

Eksporti i shërbimeve vlerësohet rreth 123 milionë dollarë. Kjo shifër përfaqëson rreth 80 për qind të asaj të të njëjtës periudhë një vit më parë. Krahasuar me periudhën paraardhese, eksporti i shërbimeve është rritur rreth 33 për qind. Rritja e eksportit është mundësuar kryesisht prej shërbimeve të turizmit të cilat zënë rreth 83 për qind të totalit, pjesën tjetër e zënë shërbimet e telekomunikacionit dhe ato qeveritare.

Importi i shërbimeve këtë tremujor zë rreth 83 për qind të tremujorit paraardhës dhe vlerësohet rreth, 1,3 herë më i lartë se tremujori i parë një vit më parë duke kapur shifrën 107 milionë dollarë. Kjo rritje është rrjedhojë e rritjes së madhe të importit të shërbimeve të turizmit, i cili në fund të tremujorit regjistroi rreth 63 milionë dollarë, shifër kjo 1,4 herë më e lartë se ajo e tremujorit korrespondues një vit më parë. Gjithashtu, rritja e importit tregtar ka çuar në rritjen e shpenzimeve për shërbimet e transportit dhe të sigurimit.



Grafik 5. BILANCI I SHERBIMEVE – SERVICES BALANCE

2.3 TE ARDHURAT

Bilanci pozitiv i të ardhurave këtë tremujor regjistroi rreth 26 milionë dollarë. Ky suficit vlerësohet rreth 54 për qind më i lartë se e njëjta periudhë një vit më parë dhe zë rreth 18 për qind të tremujorit paraardhës.


Një rol të rëndësishëm në të ardhurat kanë luajtur të ardhurat nga investimet e mjeteve valutore të sistemit bankar dhe të ardhurat nga puna e punëtorëve sezonalë.

2.4 TRANSFERTAT

Tremujori i parë u mbyll me një suficit të transfertave korente prej 118 milionë dollarësh. Ky bilanc vlerësohet rreth 2 herë më i lartë se ai i tremujorit të parë të vitit 2000 dhe rreth 1,5 herë më e ulët se ai i periudhës paraardhëse. Megjithatë, këto transferta kanë mbuluar rreth 57 për qind të deficitit tregtar të mallrave.

Dërgesat nga emigrantët, për këtë tremujor, vlerësohen rreth 124 milionë dollarë amerikanë ose rreth 2 here me të larta se në tremujorin e parë të vitit të kaluar si dhe zënë rreth 69 për qind të atyre të tremujorit paraardhës. Një shifër e tillë mund të konsiderohet si një tregues i besueshëm për një parashikim optimist për dërgesat e emigrantëve, të cilat, në zhvillime normale, duhet të arrijnë një shifër mbi 600 milionë dollarë për të gjithë vitin.

Gjithashtu, transfertat shtetërore këtë tremujor kanë rënë (këto përfaqësojnë vetëm 37 për qind të transfertave të tremujorit paraardhës), ndërkohë që këto




Grafik 6. STRUKTURA E TRANSFERTAVE – TRANSFER'S STRUCTURE

kanë kapur nivelin e fillimvitit të kaluar .

3. LLOGARIA KAPITALE DHE FINANCIARE

Deficiti relativisht i lartë i transaksioneve korente është financuar totalisht prej flukseve hyrëse të kapitaleve, bilanci pozitiv i të cilave, në fund të periudhës, vlerësohet rreth 67 milionë dollarë.



Grafik 7. FLUKSET FINANCIARE (ne mln USD)

Ky suficit vlerësohet të jetë rreth 56 për qind më i lartë se ai i tremujorit paraardhës dhe rreth 26 për qind më i lartë se ai i tremujorit të parë të vitit 1999. Pas kësaj shifre, relativisht të lartë pozitive, qëndrojnë transfertat kapitale dhe rritja e detyrimeve financiare kundrejt jorezidentëve në formën e investimeve të huaja direkte¹, huamarrjes, përdorimit të kredive të FMN-së dhe rritjes së depozitave të jorezidentëve në sistemin bankar.

3.2 DETYRIMET FINANCIARE

Detyrimet financiare të ekonomisë shqiptare, gjatë tremujorit, u rritën rreth 47 milionë dollarë. Kjo shifër është rreth 23 për qind më e lartë se ajo e tremujorit paraardhës dhe 21 për qind më e lartë se ajo e tremujorit të parë të vitit 1999.


Investimet e huaja direkte këtë tremujor vlerësohen rreth 58 milionë dollarë. Kjo shifër është rreth 3 herë më e lartë kundrejt tremujorit të parë të vitit 2000

¹ shih shpjeguesin metodologjik.

dhe rreth 2 herë më e lartë se tremujori paraardhës. Rritja e këtyre flukseve kapitale në këtë fillimviti reflekton kryesisht efektin e privatizimit të ndërmarrjeve të mëdha shtetërore. Këtu mund të përmendim muajin shkurt ku investimet e huaja vetëm nga privatizimi janë rritur me 42 milionë dollarë gjë që ka çuar edhe në rritjen e rezervës valutore.

Borxhi i Jashtëm. Kapitaleve të investuara në formën e investimeve direkte i janë shtuar dhe disbursimet e kredive nga jashtë. Këto disbursime këtë tremujor regjistruan rreth 24 milionë dollarë. Këto vlerësohen rreth 2 herë më të larta se e njëta periudhë një vit më parë ndërkohë që përfaqësojnë rreth 48 për qind të disbursimeve të tremujorit paraardhës.

Disbursimet kanë shkuar pothuajse tërësisht në favor të sektorit “Qeveria e Përgjithshme” dhe përfaqësojnë rritjen e detyrimeve të këtij sektori. Financuesit kryesorë të Shqipërisë kanë qenë Banka Botërore (IDA), Gjermania dhe Italia.



Grafik 8. DETYRIMET NDAJ KREDITOREVE TE HUAJ - DEBT OUTSTANDING DISBURSED

Gjithashtu, disbursimet e kredive nga Fondi Monetar Ndërkombëtar në fund të tremujorit të parë kapën shifrën 6.1 milionë dollarë, ndërkohë që në tremujorin paraardhës nuk ka pasur. Kjo shifër zë rreth 46 për qind të asaj të tremujorit korrespondues të një viti më parë.

Shërbimet e borxhit të jashtëm në formën e pagesave të principalit, gjatë tremujorit të parë regjistruan rreth 4.3 milionë dollarë.

Detyrimet financiare në formën e **depozitave të jorezidentëve në sistemin bankar** janë rritur me 8.1 milionë dollarë amerikanë. Kjo rritje përfaqëson rreth 60 për qind të rritjes së tremujorit të parë të vitit 2000, ndërkohë që në tremujorin paraardhës këto depozita ranë me rreth 10 milionë dollarë. Depozitat janë kryesisht në USD, të cilat zënë rreth 86 për qind të totalit dhe pasohen nga ato në DEM GRD, dhe LIT me rreth 12 për qind.

Ndryshe nga tremujori paraardhës, i cili ka regjistruar një shifër pozitive prej 22 milionë dollarësh, kredia tregtare këtë tremujor ka shënuar shifra negative prej rreth 7 milionë dollarë. Ky është një fenomen që ndodh në fillim të vitit pasi në tremujorin e parë bëhet pagesa e detyrimeve të fundvitit paraardhës.

3.2 MJETET FINANCIARE


Mjetet financiare këtë tremujor janë rritur me rreth 57 milionë dollarë. Kjo shifër vlerësohet rreth 4 here më e lartë e rritja e tremujorit paraardhës dhe vlerësohet rreth 11 herë më e lartë se ajo e periudhës korresponduese të vitit të kaluar. Kjo rritje vjen kryesisht nga rritja e mjeteve në formën e depozitave tona jashtë. Kështu, depozitat tona jashtë janë rritur me 51 milionë dollarë. Gjithashtu, vlen të përmendet këtë tremujor rritja prej rreth 2 milionë dollarësh e investimeve të portofolit, fenomen ky që është shfaqur në tremujorin e tretë të vitit 2000.

4. REZERVAT

Rezervat e autoritetit monetar, në tremujorin e parë të këtij viti, u rritën me rreth 56 milionë dollarë. Kjo rritje vlerësohet rreth 23 për qind më e lartë se ajo e tremujorit paraardhës dhe rreth 9 herë më e lartë se rritja e tremujorit të parë të vitit 2000. Faktor kryesor që ka çuar në rritjen e rezervave valutore kanë qenë flukset në formën e investimeve të huaja nga privatizimi i ndërmarrjeve të mëdha.

Gjithashtu, disbursimi i kredive nga Fondi Monetar Ndërkombëtar në kuadrin e programit ESAF2, ka rritur zotërimet e SDR-së. Në fund të tremujorit, këto të fundit vlerësohen me një rritje prej 8.1 milionë dollarësh.

Në fund të tremujorit të parë të vitit 2001, stoku i rezervave vlerësohet prej 648 milionë dollarësh.



Grafik 9. REZERVAT E AUTORITETIT MONETAR